



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 23.18.1-2017-08**

**RAPORTI I AUDITIMIT**

**PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMPANISË PËR  
MENAXHIMIN E DEPONIVE TË KOSOVËS SH.A.**

**PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës sh.a, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme Vlora Spanca, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Senver Morina dhe Ernes Beka, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Enver Boqolli.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	22
5 Qeverisja.....	23
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	27
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme .....	30
Shtojca III: Letër Konfirmimi.....	35

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 13/11/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar bazuar në cilësinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i KMDK-së.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

### Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

#### Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**

Kryesuesi i Bordit është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e KMDK-së. Ne kemi analizuar veprimtarinë e KMDK-së se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP-së).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i PFV-ve merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. PFV-të përgatiten dhe nënshkruhen nga Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit (ZKFTH) dhe Kryeshefi Ekzekutiv (KE) dhe dorëzohen për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Opinioni i kualifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e KMDK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhjes së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, pasqyrat financiare vjetore paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale të realizuara të KMDK-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parmit akrual<sup>1</sup> të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

#### Baza për opinion të kualifikuar

Llogarit e pagueshme për tatim dhe kontribute të prezantuara në PVF ishin në vlerë 191,706€. Ne nuk ishim në gjendje të konfirmojmë vlerën e kësaj llogaritje në mungesë të një raporti apo gjendjes<sup>2</sup> nga Administrata Tatimore e Kosovës.

<sup>1</sup> Parimi Akrual nënkupton, Njohjen e transaksioneve dhe ngjarjeve në kohën kur ato të ndodhin e jo kur paraja e gatshme është pranuar ose paguar.

<sup>2</sup> Raport i gjendjes së përgjithshme të deklarimeve dhe të transaksioneve të tatimpaguesit i cili gjenerohet nga sistemi i ATK-ës

Kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore dhe ndërmarrjeve publike në Kosovë. ZKA është e pavarur nga KMDK dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin.

### Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- **Mos sigurimi i vazhimit të licencës për administrimin e mbeturinave.** KMDK menaxhon Deponit e Mbeturinave në rreth 70% të territorit të Kosovës. Ligji për Mbeturina nr. 04/L-60 (neni 16 pika 1), kërkon "Mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin, përpunimin, magazinimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave e bënë vetëm personi i licencuar". Edhe përkundër përpjekjeve për sigurimin e licencës (dhe rekomandimit tonë nga viti paraprak), kompania ende vazhdon të operoj me licencë të përkohshme prej vitit 2012, për shkak të mos përgjigjes nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; dhe
- **Mos sigurimi i tarifores për deponimin e mbeturinave.** Ligji për Mbeturina nr. 04/L-60 neni 14 pika 2, thotë, "Në bazë të dispozitave të Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe këtij ligji, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në marrëveshje me Komunitat përkatëse përcakton tarifën për deponimin e mbeturinave komunale në deponit e caktuara". KMDK nuk kishte arrit të siguroj tarifën sipas kësaj kërkesë dhe ende vazhdon që shërbimet e veta t'i faturoj në bazë të tarifores së trashëguar nga ZRRUM<sup>3</sup> të vitit 2012. Kjo tarifore (e skaduar) mbulon vetëm mbledhjen e mbeturinave të amvisërisë me vlerë 5.31€/ton. Kompania vazhdon të pranojë lloje tjera të mbeturinave për të cilat nuk kishte licence as tarifore, siç janë: deponimin e qelqit, gomës, mbeturinat e dheut dhe gurëve, mbetje shtazore dhe asgjësimin e mbeturinave të doganës. Për këto lloje të mbeturinave, Bordi i Drejtorëve të kompanisë në janar të 2016 kishte caktuar tarifën në vlerë prej 50€/ton. Ketë veprim kompania e kishte bërë shkak i mos përgjigjes nga organi kompetent për caktimin e tarifave, respektivisht MZHE.

### Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Kryesuesi i Bordit të KMDK-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit aktual sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

<sup>3</sup> ZRRUM – Zyra e Rregullatorit të Ujërave dhe Mbeturinave



---

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të KMDK-së.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

## **2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim**

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik (me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përmbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore; dhe

---

Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përgatisë raportet si në vijim:

- Statuti i NP-së;
- Plani i Biznesit;
- Raporte tremujore;
- Raporte vjetore;
- Raportin nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
- Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Në draft PFV-të të datës 02/02/2018 ishin të nevojshme disa korrigjime financiare në bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, dhe shënimet shpjeguese që ishin përcjellë me gabime. Në bazë të sugjerimeve tona, ato kryesisht janë korrigjuar në PFV-të e datës 22/03/2018.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, pasqyrat financiare vjetore të përgatitura nga KE dhe ZKFTH, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në BD, përveç efekteve të përmendura të baza për opinion, PFV paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar së kompania deri në datën 16.03.2018 nuk e kishte përgatitur raportin vjetor për vitin 2017.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi 1** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim dhe Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit, dhe të merren të gjitha veprimet që çështjet që kanë ndikuar modifikimin e opinionit të korrigjohen dhe të mos përsëriten.

Gjithashtu Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga ZKA dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen Bordit Drejtues.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në KMDK. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i të hyrave, shpenzimeve, pasurive, detyrimeve dhe llogarive të arkëtueshme.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

KMDK krahasuar me vitin e kaluar ka treguar progres të dukshëm në aspektin e forcimit të kontroleve në menaxhimin e përgjithshëm të kompanisë. Megjithatë, janë ende disa fusha të cilat kanë nevojë për përmirësime të mëtejme. Me theks të veçantë, proceset ekzistuese të planifikimit të buxhetit duhet të përmirësohen për të reflektuar ndryshimet gjatë vitit.

Shpenzimet për blerje të mallrave duhet të planifikohen me qëllim që të evitohet shmangia nga procedurat e hapura. Për më shumë, mungesa e rregullores për menaxhimin e pasurisë rrezikon që pasuritë të mos trajtohen në mënyrën e duhur dhe rrjedhimisht kjo ndikon në prezantimin jo të saktë të pasurive në pasqyrat financiare.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga BD për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin në KMDK.

### 3.1 Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

**Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2017 (në €)**

Përshkrimi	Planifikimi fillestar	Plani përfundimtar	Realizimi 2017	Realizimi 2016
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	1,556,358	1,591,008	1,557,553	1,559,119
Të hyrat nga subvencionet	0	0	114,583	200,000
Të hyrat nga grantet e shtyera	0	0	463,344	79,721
Të hyrat tjera	0	0	71,034	12,575
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>1,556,358</b>	<b>1,591,008</b>	<b>2,206,514</b>	<b>1,851,415</b>
Shpenzimet për paga	782,389	775,226	705,346	601,366
Shpenzimet operative <sup>4</sup>	670,760	712,760	694,598	701,847
Shpenzimet e zhvlerësimit			595,879	871,980
<b>Gjithsej Shpenzimet</b>	<b>1,453,149</b>	<b>1,487,986</b>	<b>1,995,823</b>	<b>2,175,193</b>

Shpjegimet rreth ndryshimeve në planifikimin dhe realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve për zërat me peshë më të lartë janë dhënë si në vijim:

- Të hyrat nga shitjet/shërbimet ishin realizuar në vlerë 1,557,553€ nga 1,591,008€ të planifikuara, apo 98% kundrejt planit vjetor. Krahasuar me vitin paraprak ishin realizuar me pak për 1,566€.
- Të hyrat nga subvencionet ishin realizuar 114,583€ edhe pse nuk ishin të planifikuara me plan të biznesit. Krahasuar me vitin paraprak ishin pranuar në një shumë më të ulët për 85,417€.
- Të hyrat nga grantet e shtyera ishin realizuar 463,344€ edhe pse nuk ishin të planifikuara me plan të biznesit. Krahasuar me vitin paraprak kishin pranuar një shumë më të lartë për 383,623€, kjo kishte rrjedhë si rezultat i korigjimeve të bëra në pasuritë (deponitë sanitare dhe pajisjeve) të pranuar si donacione.
- Të hyrat tjera ishin realizuar 71,034€ të cilat nuk ishin të planifikuara në planin e biznesit. Krahasuar me vitin paraprak ishin me të larta për 58,459€.
- Shpenzimet për paga dhe mëditje ishin realizuar 705,346€ nga 775,225€ të planifikuara apo 91%. Krahasuar me vitin paraprak ishin më të larta për 103,980€ apo 17%.

<sup>4</sup> Shpenzimet operative përfshijnë: shpenzimet për mirëmbajtje, derivate, të konsulences, të sigurimit, të qirasë, telefonit, administrative dhe komunalit etj.

- Shpenzimet operative të planifikuara prej 712,760€, ishin realizuar 694,598€ apo 97%. Krahasuar me vitin paraprak kemi një zvogëlim të shpenzimeve prej 7,249 apo 1%.
- Shpenzimet e zhvlerësimit të vitit 2017 ishin 595,879€, krahasuar me ato të vitit paraprak që ishin 871,980€. Në 2017, shpenzimet e zhvlerësimit janë zvogëluar për 276,101€ apo 46%, kjo ka ndikuar nga rivlerësimi i zgjatjes së jetëgjatësisë së deponive sanitare.

## Çështja 2 – Planifikimi jo i duhur i planit të biznesit

- E gjetura** Ne kemi trajtuar përmbajtjen e planit të biznesit i cili i përmban synimet afariste dhe financiare të cilat kompania synon ti arrijë gjatë vitit 2017 si dhe qasjen për realizimin e këtyre synimeve. Kompania në plan të biznesit nuk kishte paraparë të bëjë rivlerësimin e pasurive. Rivlerësimi i bërë nga kompania kishte reflektuar në korrigjimin e jetë gjatësisë së deponive sanitare (që janë të hyra të shtyra nga garantët qeveritare dhe donacionet) që njihen konform pjesës së zhvlerësuar të tyre të cilat reflektuan në zgjatjen e jetë gjatësisë së deponive sanitare. Kjo për shkak të kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshëm gjatë hartimit dhe rishikimit të planit të biznesit.
- Rreziku** Hartimi i planit të biznesit duke mos e paraparë nevojën e rivlerësimit të pasurive të cilat i kishte rivlerësuar kompania, e bënë planin jo gjithëpërfshirës dhe jo real duke rritë rrezikun që të mos realizohen të gjitha synimet e sajë në periudhën përkatëse.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që gjatë hartimit të planit të biznesit përfshin të gjitha aktivitetet e saj që mund të ndodhin gjatë vitit.

## Çështja 3 – Mos pagimi i shtesës së përvojës në punë

- E gjetura** Neni 48.1 i Marrëveshjes së përgjithshme kolektive të Kosovës, parasheh që të punësuarve, t’iu njihet e drejta e shtesës për përvojë në punë, 0.5% të pagës bazë, për çdo vit të plotë të përvojës në punë. Edhe pse, kompania e kishte parashikuar këtë në planin e biznesit, nuk kishte arritur ta përmbushë këtë obligim ndaj punëtorëve. Kjo për shkak të kontrolleve jo të mjaftueshme në planifikim dhe realizim të buxhetit.
- Rreziku** Mos përmbushja e obligimeve ndaj punëtorëve mund ta ekspozoj kompaninë para rreziqeve për pagesa të ndëshkimeve dhe interesa.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që janë marrë veprimet e nevojshme për t’i paguar obligimet ndaj punëtorëve për pagesën e shtesës së përvojës në punë.

### 3.2 Bilanci i gjendjes<sup>5</sup> (Pasqyra e pozitës financiare)

Ne kemi bërë auditimin e bilancit të gjendjes, duke i testuar edhe gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

**Tabela 2: Bilanci i gjendjes së KMDK më 31 dhjetor 2017** (në €)

<b>Pasuritë</b>	<b>Viti 2017</b>	<b>Viti 2016</b>	<b>Detyrimet dhe Ekuiteti</b>	<b>Viti 2017</b>	<b>Viti 2016</b>
Paraja ne banke dhe arke	67,655	55,065	Llogarite e pagueshme tregtare	292,924	421,402
Stoqet <sup>6</sup>	23,306	20,562	Llogarite tjera të pagueshme	3,044	1,855
Llogaritë e arkëtueshme	878,692	1,204,315	Obligime për tatime dhe kontribute	191,706	267,432
Llogarit tjera të arketueshme	38,213	5,248	Të hyrat e shtyra nga garantët dhe doncionet	1,593,336	2,056,679
Objektet ndërtimore	1,703,951	2,047,143	Kapitali themelor	25,000	25,000
Pajisjet dhe makineritë	744,794	425,349	Kapitali rezerve	1,440,299	1,262,299
			Humbjet/ fitimet e bartura	-277,046	46,732
			Fitimi/Humbja e vitit	187,348	(323,778)
<b>Gjithsej pasuritë</b>	<b>3,456,611</b>	<b>3,757,682</b>	<b>Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti</b>	<b>3,456,611</b>	<b>3,757,682</b>

<sup>5</sup> SNK termin "Bilanc i Gjendjes" e kanë ndryshuar dhe emërtuar "Pasqyra e Pozitës Financiare", por derisa kompania e ka emërtuar bilanci i gjendjes edhe ne ju kemi referuar këtij emërtimi për të qenë konsisten me emërtimin e vet PFV-ve të cilat po i Auditojme.

<sup>6</sup> Në stoqe janë përfshirë rezervat e derivateve dhe vajrave në depo

---

**Çështja 4 - Mungesa e një rregulloreje për menaxhimin e pasurive jo qarkulluese**

- E gjetura** Sipas nenit 7.2 dhe 7.3 të Statutit, KMDK duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e shoqërisë. Ne kemi vërejtur se kompania nuk kishte një rregullore për menaxhimin e pasurisë e cila duhet të përshtatet me nevojat dhe kërkesat e kompanisë duke u mbështet me standardet dhe rregullat në fuqi. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit të rëndësisë së rregullores për menaxhimin e pasurive jo qarkulluese.
- Rreziku** Mungesa e rregullores për menaxhimin e pasurisë rrezikon që pasuritë të mos trajtohen në mënyrën e duhur dhe rrjedhimisht kjo mund të ndikoj në prezantimin jo të saktë të pasurive në pasqyrat financiare.
- Rekomandimi 4** Kryesuesi i Bordit duhet që brenda një afatit sa më të shkurtër të hartoj një rregullore të brendshme mbi menaxhimin e pasurive, ku do të përshkruheshin të gjitha procedurat për përdorimin e pasurive (të drejtat dhe përgjegjësitë e stafit).

### 3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

KMDK-ja në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave dhe të gjitha shpenzimet që ka krijuar gjatë vitit, si dhe rezultatin financiar.

**Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2017**

Përshkrimi	Viti 2017	Viti 2016
Të hyrat nga shitjet/shërbimet	1,557,553	1,559,119
Të hyrat nga subvencioni - MZHE	114,583	200,000
Të hyrat e shtyra	463,344	79,721
Të hyrat nga shlyerja e detyrimeve sipas vendimeve të BD	70,924	0
Të hyrat tjera	110	12,575
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>2,206,514</b>	<b>1,851,415</b>
Pagat dhe mëditje	705,346	601,366
Shpenzimet tjera operative	642,254	670,957
Provizionimi për borxhet e këqija sipas vendimeve të BD	34,760	0
Shlyerjet e parapagimeve sipas vendimeve të BD <sup>7</sup>	17,584	30,890
Shpenzimet e zhvlerësimit për vitin 2017	595,879	871,980
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>1,995,823</b>	<b>2,175,193</b>
<b>Fitimi/Humbja para tatimit</b>	<b>210,691</b>	<b>(323,778)</b>
Tatimi në fitim	(23,343)	0
<b>Fitimi / Humbja neto</b>	<b>187,348</b>	<b>(323,778)</b>

Kompania këtë vit kishte realizuar fitim shkak i efekteve të korigjimeve të bëra për njohjen e të hyrave të shtyra nga vitet paraprake dhe efekteve të zvogëlimit të shpenzimeve të zhvlerësimit për arsye të rritjes së jetëgjatësisë së deponive sanitare pas rivlerësimit.

Ekzaminimet tona audituese lidhur me pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kanë rezultuar me gjetjet si në vijim:

<sup>7</sup> Këto shlyerje janë regjistruar si shpenzime pasi janë shlyer parapagimet që ishin regjistruar dhe njohur vite me herët.



---

## Çështja 5 - Keq klasifikim i fletëngarkesave në bazë të llojit të mbeturinave

- E gjetura** Në 6 fletëngarkesa, KMDK nuk i ka respektuar kodet e caktuara për klasifikimin e llojeve të ndryshme të mbeturinave siç janë: mbeturinat e amvisërisë, mbeturinat e qelqit, mbeturinat për dheun dhe gurët, mbeturinat për gomë dhe mbeturinat e asgjësimit (eshtra, mbeturina doganore). Kjo ka shkaktuar që mbeturinat e një lloji të klasifikohen dhe të sistemohen në deponi sanitare si lloje tjera në vend të klasifikimit adekuat. Kjo për shkak të gabimeve gjatë procesit të matjeve.
- Rreziku** Mos klasifikimi i duhur sipas llojit të mbeturinave mund të shkaktojë faturime të pa sakta, kur njeri lloj i mbeturinave të ketë çmime të ndryshme nga tjetri lloje, dhe kjo ndikon drejtpërdrejt në të hyrat e kompanisë.
- Rekomandimi 5** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se mbeturinat e deponuara regjistrohen sipas llojit dhe kategorizimit të tyre. Gjithashtu, të forcoj kontrollet e brendshme për të eliminuar gabimet në klasifikim të tyre sipas llojeve.

## Çështja 6 - Blerja e mallrave dhe shërbimeve pa procedura të prokurimit

- E gjetura** Neni 16.3 i Ligjit të Prokurimit Publik (LPP) thekson se: Vlera e secilës kontratë duhet parashikuar dhe procedura e prokurimit përcaktohet konform vlerës. AK nuk do të ndajë kërkesën për prokurim për një sasi të caktuar të produkteve me qëllim të zvogëlimit të vlerës së kontratës për furnizim nën kufirin e caktuar në nenin 19 të këtij ligji. Çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është e barabartë me ose më e madhe se, ose me arsye pritet të jetë e barabartë me ose më e madhe se një mijë (1.000€), por më e vogël se dhjetë mijë (10.000€) konsiderohen "kontrata me vlerë të vogël, si dhe çdo kontratë publike vlera e parashikuar e së cilës është më e vogël se, ose me arsye pritet që të jetë më e vogël se një mijë (1.000€) konsiderohet si "Kontratë me vlerë minimale".
- Nga pagesat e testuara ne kemi vërejtur se në 5 (pesë) raste kompania kishte bërë blerje direkt nga operatorët ekonomik duke anashkaluar procedurat e prokurimit.

Arsyet sipas kompanisë ishin: sepse ato ishin me vlera të vogla dhe për më shumë kishte lidhur Memorandume mirëkuptimi për shërbime të ndërsjella me operatorët ekonomik, e cila nuk është në pajtim me LPP-në. Në analizën tonë të bazës së shpenzimeve të kompanisë kemi vërejtur se kishte disa blerje të mallrave ose shërbimeve me të njëjtën operator ekonomik ku disa prej tyre ishin bërë me para të gatshme (petty cash) me vlera nën 100€. Vlera e përgjithshme e pagesave kalon kufirin e caktuar prandaj Autoriteti Kontraktues ishte dashur të përdor njërën nga llojet e kontratave të nenit të lartcekur të LPP-ës. Këto blerje kanë ndodhur si rezultat i mungesës së funksionimit të duhur të kontrolleve të brendshme. Rastet e identifikuar po i paraqesim si në vijim:

- 20 pagesa Servisim të kontejnerëve dhe dyerve, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 1,871€;
- 18 pagesa për Larjen e makinerisë, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 1,503€;
- 15 pagesa për Largimin e ujërave të zeza, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 1,425€;
- 15 pagesa për punë me Skip, vlera e përgjithshme e të cilave ishte 9,186€;
- Pesë pagesa për Furnizim me derivate vlera e përgjithshme e të cilave ishte 22,650€ (për këtë furnizim ishin zhvilluar procedurat e prokurimit, por ishin në procedurë ankimore në Organin Shqyrtues të Prokurimit).

Mangësitë e identifikuar kishin ndodhur për shkak të mos funksionimit të mjaftueshëm të kontrolleve të brendshme.

**Rreziku**

Blerja e mallrave dhe shërbimeve duke anashkaluar procedurat e prokurimit rrezikon që kompania të dëmtoj buxhetin duke mos arritur vlerën për paranë e shpenzuar dhe kufizim të konkurrencës.

**Rekomandimi 6**

Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marrë të gjitha veprimet për forcimin e kontrolleve të brendshme për të bërë një vlerësim dhe planifikim të nevojave të kompanisë dhe artikujt e ngjashëm të grupohen dhe të përdoren procedurat e prokurimit sipas kërkesave të LPP-së, për të shmangur ndarjen e kontratave të blerjeve të njëjta në disa sosh.

### 3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të kompanisë, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

**Tabela 4: Kapitali i KMDK-së më 31.12.2017**

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>KAPITALI</b>	<b>1,375,601</b>	<b>1,010,252</b>
Kapitali themeltar	25,000	25,000
Kapitali rezervë	1,262,299	1,262,298
Rivlerësim i pasurive jo qarkulluese	178,000	0
Fitimet/Humbjet e bartura	-277,046	46,732
Fitimet/Humbja e vitit aktual	187,348	-323,778

Gjatë vitit 2017 kompania ka bërë rivlerësim e deponive sanitare nga një komision i formuar nga BD për rivlerësimi e tyre dhe nga rezultati i këtij rivlerësimi ka njohur vlerë të re të këtyre pasurive duke e rritur vlerën e këtyre pasurive për 178,000€.

#### **Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve afariste, financiare dhe investimit. Informatat rreth rrjedhës së parave të ndërmarrjes janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

**Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme**

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>Paratë neto nga aktivitetet operative</b>	<b>292,137</b>	<b>24,504</b>
Pranimet e parasë nga shitjet/shërbimet	1,953,336	1,990,346
Pagesat ndaj furnitorëve	(820,087)	(1,219,233)
Pagat e punëtorëve	(673,706)	(579,860)
Pagesat e interesit	(969)	(2,417)
Pagesat për tatime	(108,537)	(102,694)
Pagesat tjera te parasë për aktivitete operative	(57,900)	(61,638)
<b>Paratë neto nga aktivitetet investive</b>	<b>(394,130)</b>	<b>(184,370)</b>
Pagesa për blerja e pajimeve/makinerive/impianeteve	(394,130)	(184,370)
<b>Paratë neto nga aktivitetet financuese</b>	<b>114,583</b>	<b>200,000</b>
Pranime nga aktiviteti financues (Subvencioni nga MZHE)	114,583	200,000
<b>Rritja/zvogëlimi i parasë gjatë vitit 2017</b>	<b>12,590</b>	<b>40,134</b>
Paraja në fillim të vitit 2017	55,065	14,931
<b>Paraja në fund të vitit 2017</b>	<b>67,655</b>	<b>55,056</b>

Dalja e parasë të aktiviteti investues ka të bëjnë me blerjen e një buldozeri, një automjeti për operativë, investimi në Deponit Sanitare, furnizimi me kontejner dhe servisimi i tyre, investimi në pjesë rezervë, etj.

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

### 3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre. Kompania i ka bërë prezantimet e nevojshme në shënimet shpjeguese të PFV-ve duke i prezantuar politikat e kompanisë që i aplikon dhe duke i shpjeguar zërat të cilët kanë shuma të grumbulluar në njërin nga pjesët e PFV-ve.

#### Çështja 7 - Shënimet shpjeguese jo të mjaftueshme për disa zëra

**E gjetura** Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë në bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet ose pasqyrën e rrjedhës së parasë, duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese.

Gjatë analizimit të shënimeve shpjeguese janë identifikuar dobësitë si në vijim:

- Nuk ishin prezantuar informacione shpjeguese lidhur me paranë e gatshme se sa janë në bankë dhe sa në arkë, por vetëm shuma e përbashkët e grumbulluar është prezantuar në shënimet shpjeguese njëjtë sikur të bilanci i gjendjes së PFV-ve; dhe
- Tek stoqet nuk ishte shpjeguar se çka përmbajnë, llojet dhe sasi të tyre, por vetëm një shumë e grumbulluar dhe e pa specifikuar ishte prezantuar në shënimet shpjeguese, njëjtë sikur të bilanci i gjendjes së PFV-ve.

Kjo për mungesë të konsultimit të SNK dhe kontrolleve të brendshme të mjaftueshme.

**Rreziku** Prezantimi i shumave të njëjta në shënimet shpjeguese me ato të zërave në bilancin e gjendjes nuk i benë të qarta dhe të kuptueshme shënimet shpjeguese dhe kjo rrite rrezikun që lexuesi i tyre të mos jetë në gjendje të kuptojë drejtë PFV.

**Rekomandimi 7** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se gjatë hartimit të PFV-ve në shënimet shpjeguese të prezantohen informacione të detajuara dhe të plota për secilin zë të PFV.

---

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të KMDK-së kishte rezultuar me 16 rekomandime kryesore. Kompania kishte përgatitur një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, ku kishte paraqitë mënyrën se si do t'i zbatoj ato rekomandime, duke përcaktuar afatet dhe zyrtarët përgjegjës. Nga 16 rekomandimet e dhëna, 6 (gjashtë) prej tyre janë zbatuar, 8 (tetë) janë në proces të zbatimit, dhe 2 (dy) rekomandime mbeten të pa zbatuara. Ndërsa nga pesë qeshjet që ndikuan në opinionin e vitit të kaluar, katër prej tyre janë zbatuar dhe njëra ende nuk është zbatuar.

Ndërsa, në auditimin e PFV-ve të vitit 2015 ishin dhënë 3 (tri) rekomandime për të cilat kompania nuk kishte përgatitur plan veprimi për zbatimin e tyre. Megjithatë, një është zbatuar, një ishte në proces të zbatimit ndërsa një nuk ishte zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

---

### Çështja 8 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- |                      |  |
|----------------------|--|
| <b>E gjetura</b>     | Përkundër progresit në zbatimin e rekomandimeve ende një pjesë rekomandimeve kanë mbetur të pa zbatuara. Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dala nga auditimi. Nuk kemi vërejtur se KMDK-ja aplikon masa përgjegjësie për moszbatimin e rekomandimeve. |
| <b>Rreziku</b>       | Mos zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake rrit rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta të cilat ndërliken me PFV dhe me kontrollet e brendshme.   |
| <b>Rekomandimi 8</b> | Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që ka ndërmarr veprime konkrete për zbatimin e plot të të gjitha rekomandimeve të auditimit të vitit të 2016 dhe atij 2015.  |

## 5 Qeverisja

### Hyrje

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda KMDK-së veçanërisht në lidhje me mungesën e një plani për menaxhimin e rrezikut, ndikimin e ulët të auditimit të brendshëm në rritjen e efikasitetit të kontroleve të brendshme cilësinë jo të mirë të raporteve tremujore. Këto mangësi mund të kenë ndikim tek kompania në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

#### 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) operon me një staf i cili njëherit është Drejtori i NjAB. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës të punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të KMDK dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

Raportet e NJAB ishin kryesisht raporte mbi analizën e të hyrave, të shpenzimeve, të prokurimit, të projekteve të veçanta dhe të tremujoreve (TM) të ndryshëm, të cilat shumica nuk kishin ndonjë gjetje apo rekomandim për menaxhmentin.

---

## Çështja 9 – Funksonimi i NJAB-së jo në cilësinë e duhur

**E gjetura** Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) për vitin 2017 kishte planifikuar shtatë auditime të rregullta dhe një auditim ad-hoc duke mos përcaktuar afatin kohor të fillimit dhe përfundimit të auditimeve. NJAB për vitin 2017 kishte arritur të përfundoj 12 auditime duke dhënë 5 rekomandime. Pavarësisht numrit të raporteve të auditimit të AB, cilësia e tyre nuk ishte në nivelin e duhur meqenëse kryesisht ishin përshkruese pa ndonjë ndikim në përmirësimin e kontrolleve të brendshme.

Raportet e auditimit nuk ishin të protokolluara si dhe auditori i brendshëm nuk posedon dosje të auditimit për raportet e përfunduara në mënyrë që të mbështes me dëshmi të gjeturat dhe rekomandimet e dhëna.

Këto rezultate pasqyrojnë mungesën e vëmendjes së Menaxhmentit në njohjen dhe maksimizimin e përfitimit të auditimit të brendshëm për të kërkuar siguri për funksionimin efektiv të kontrolleve të brendshme apo qeverisjes së mirë.

**Rreziku** Cilësia jo e duhur e punës së auditorit të brendshëm, mos dokumentimi i punës dhe dhënia e rekomandimeve jo adekuate nga NJAB, rrit rrezikun që dobësitë e ekzistuese të vazhdojnë të mbesin të pa përmirësuara.

**Rekomandimi 9** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që është arritur përfitimi maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm. Komiteti i Auditimit duhet të sigurojë funksionimin adekuat të NJAB-së, duke rishikuar në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik, ofrojnë siguri dhe raportim cilësor për menaxhmentin. Po ashtu, të sigurojë se NJAB ka përgatitur dosjen e auditimit për të vërtetuar se të gjeturat janë mbështetur me dëshmi.

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.



---

**Çështja 10 - Kontrollat e menaxhimit të rreziqeve financiare, operativ dhe mjedisore janë të pamjaftueshme**

**E gjetura** Si pasojë e kontrolleve të brendshme jo të mjaftueshme, disa nga objektivat e planit nuk janë arritur. Kompania përballet me rreziqe financiare dhe rreziqe operative, teknologji të vjetruara, kosto të lartë të shërbimeve, tarifa të ulëta dhe rreziqe të jashtme si infrastrukture, mjedisore dhe të katastrofave.

Sa i përket rreziqeve mjedisore dhe ekologjike sidomos të Deponit Sanitare kompania ka rrezik të lartë për shkak të rrjedhjes së ujërave të zeza dhe depërtimit në ujërat nëntokësorë të cilat mund të ndotin, të kontaminojnë lumenjtë dhe hapësirat për rreth tyre. Gjasat për ndodhjen e këtij rreziku janë të mëdha dhe ndikimi është shumë i lartë si rrezikim i stafit që punon aty, popullatës përreth, ndotja e ujërave dhe ajrit.

Menaxhmenti nuk posedon ndonjë regjistër që identifikon rreziqet e ndryshme financiare, operative dhe mjedisore që mund t'i kërcënojnë aktivitetet e saj, me qëllim të identifikimit dhe zvogëlimit të tyre në nivel të pranueshëm. Kompania në plan të biznesit ka planifikuar shumën 28,380€ për shpenzime të pa parapara, për qëllime të mbulimit të këtyre rreziqeve. Kjo shume e ndarë për këto qëllime është shume e ulet në raport me rreziqet që kompania ballafaqohet nga aktivitetit i saj. Kjo për shkak të nënvlerësimit të tyre dhe mungesës së fondeve.

**Rreziku** Kërkesat e dobëta të kontrollit të brendshëm zvogëlojnë aftësinë e menaxhmentit për të reaguar ndaj sfidave me kohë. Po ashtu, mungesa e një regjistri të rreziqeve potenciale dhe veprimeve ndaj tyre ndikon në pamundësinë e reagimit me kohë dhe në arritjen e objektivave të kompanisë.

**Rekomandimi 10** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është hartuar plani për menaxhimin e rreziqeve si operative dhe financiare, të vlerësoj ndikimin e tyre në rast se ato ndodhin, të përcaktoj masat parandaluese ndaj tyre, si dhe të ndaj një provizion të mjaftueshëm për mbulimin e dëmeve të mundshme të shkaktuara ndaj ambientit.

## Çështja 11 – Raportet tremujore jo sipas kërkesave ligjore

**E gjetura** Sipas nenit 31 të Ligjit për NP-të, brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik, zyrtarët e NP-së do të përgatisin dhe dorëzojnë tek BD një raport për tremujorin e sapo përfunduar i cili përmban si vijon:

- një pasqyrë të strukturës organizative të NP-së, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e konsiderueshme që janë bërë gjatë tremujorit përkatës;
- një shqyrtim të performancës afariste dhe financiare gjatë tremujorit përkatës;
- një përmbledhje të të gjitha procedurave gjyqësore që mund të përfshijnë NP-në ose që NP pritet t'i iniciojë gjatë tremujorit aktual;
- transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse; dhe
- sugjerime dhe propozime për ndryshime të cilat me arsye pritet që ta rrisin performancën e NP-së.

Gjatë rishikimit të dy raporteve të tremujorëve të parë të vitit kemi vërejtur se kompania nuk kishte arritur t'i përmbushë plotësisht kërkesat ligjore lidhur me përmbajtjen e raporteve tremujore për vitin 2017. Këto raporte nuk i përmbajnë dy nga pesë kërkesat e me sipërme, respektivisht “transaksionet e konsiderueshme që përfshijnë NP ose njësitë e saj ndihmëse” dhe “sugjerime dhe propozime për ndryshime të cilat me arsye pritet që ta rrisin performancën e NP-së”.

**Rreziku** Mos përmbushja e kërkesave për raportim tremujore, nxjerr në pah mungesën e kontrollit të brendshëm mbi saktësinë dhe plotësinë e të gjitha kërkesave për raportim, gjegjësisht paraqet dobësitë e funksionimit të kontrollit të brendshëm të cilat rezultojnë me transparencë jo të mjaftueshme të aktiviteteve të kompanisë.

**Rekomandimi 11** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që procesi i përgatitjes së raporteve tremujore të jetë dizajnuar në atë formë që të ketë një përmbajtje të plotë të kërkesave ligjore dhe vetëm pas një shqyrtimi gjithëpërfshirës në lidhje me përmbajtjen dhe cilësinë e tyre, të miratohen nga BD.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinionin të kualifikuar, opinionin të kundërt dhe mohimin të opinionit.

---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1. Prona, bartja në periudhë dhe ruajtja.	Duhet bërë testimi i dëmit të aseteve në baza periodike në mënyrë që të përcaktohet vlera e rikuperueshme e aseteve, ose nëse kompania ka mundësi dhe nëse në nivel të vendit ka institucion të ekspertit vlerësues, të angazhohen vlerësues të pavarur dhe profesional të cilët do të përcaktojnë vlerën reale të aseteve.		Është bërë një lloji rivlerësimi i jetëgjatësisë së deponive, dhe rivlerësimi i pajisjeve të kategorisë III sipas një vendimi të BD.	
2. Provizionet për rastet gjyqësore/detyrimet kontigjente.	Kërkohej njohja e provizioneve për rastet gjyqësore (posaçërisht ato me rrezikshmëri të lartë dhe të humbura në procese gjyqësore) në harmoni me kërkesat e ligjore si dhe të standardeve të kontabilitetit. Kjo do të bënte që biznesi të ka informata më të sakta mbi gjendjen e detyrimeve të kompanisë.			Provizionet për rastet gjyqësore dhe detyrime kontigjente nuk është zbatuar.
3. Llogarite e arkëtueshme .	Ne i rekomandojmë menaxhmentit të kompanisë të përlllogarisë në baza të rregullta periodike dhe vjetore dëmin e llogarive të arkëtueshme dhe të prezantoj llogaritë e arkëtueshme në vlerën e tyre neto të rikuperueshme. Këto veprime konsiderojmë se duhet të bazohen në rregullativën ligjore të Kosovës, si dhe standardet të cilat rregullojnë këtë lëmi.	Është nxjerr një rregullore nga BD për njohjen e provizioneve, borxheve të këqija. Pra është zbatuar.		

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1. Pasqyrat financiare vjetore	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kualifikuar. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet dhe për ta siguruar vlerësimin e saktë të llogarive të arkëtueshme, pasurisë, detyrimeve dhe ekuitetit.		Gjatë hartimit të PFV të vitit 2017 kompania i ka adresuar çështjet e gabimeve në llogari të arkëtueshme, të obligimeve dhe në ekuitet. Megjithatë, në PVF-të për 2017 llogaritë e pagueshme për tatime dhe kontribute pensionale në vlerë 191,706€ në mungesë të dëshmisë relevante nga ATK, ne nuk arritëm ta konfirmojmë.	
2. Obligimet tjera për raportim të jashtëm	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Pasqyrat Financiare duhet të aprovohen nëse ndaj draft PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.	Kërkesat tjera për raportim të jashtëm ishin adresuar.		

3. Mos zbatimi i rekomandim eve nga viti paraprak	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që është përpiluar dhe zbatuar plani i veprimit, nëse paraqitet nevoja i njëjti plan duhet të rishikohet, duke përcaktuar saktë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Jashtëm, me prioritet në fushat më të rëndësishme.		Kompania ka përpilua planin e veprimit. Gjatë auditimit është vërejtur se rekomandimet e vitit paraprak janë në proces të zbatimit të tyre.	
4. Mangësi në planin e biznesit	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë përdorur të gjitha mekanizmat për adresimin e çështjeve të identifikuar dhe të bëjë përpjekje për menaxhimin e rrezikut në mënyrë më të përshtatshme për t'i zvogëluar ato deri në nivel të pranueshëm. Kjo mund të bëhet përmes hartimit të planit të veprimit për monitorimin e arritjes së objektivave dhe duke vendosur funksione efektive të mbikëqyrjes.		Kompania ka bërë përpjekje vetjake për menaxhimin e rrezikut operativ duke e parashikuar në planin e biznesit, por kjo parasheh edhe mbështetjen financiare nga aksionari të cilën ende se ka arrite.	
5. Dobësi në kontrollet menaxheriale	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është kryer një rishikim detaj për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme		Kontrollet menaxheriale të veprimtarisë rreth një zgjidhje më të përshtatshme janë në proces të zbatimit.	
6. Mangësitë në funksionimin e NJAB-së	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se është arritur përfitimi maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm. Komisioni i Auditimit duhet të sigurojë funksionimin adekuat të NJAB-së, duke rishikuar në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik, ofrojnë siguri dhe raportim kualitativ për menaxhmentin.			Rekomandimi rreth funksionimit të NJAB nuk është zbatuar.



7. Realizimi i buxhetit	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që performanca buxhetore është monitoruar në mënyrë sistematike në baza mujore dhe që ky rishikim i identifikon dhe adreson barrierat për realizim të buxhetit në nivel të planifikuar.		Monitorimi i realizimit të buxhetit tani bëhet vetëm në baza tremujore, por ende jo në baza mujore.	
8. Mangësi në pajtueshmëri në me ligjet	Kryesuesi i Bordit duhet të ndërmarrë hapa shtesë me qëllim të sigurimit të licencës dhe caktimit të tarifave nga organet kompetente.		Janë ndërmarr hapa shtesë rreth sigurimit të licencës dhe tarifores, por pa sukses, pasi kjo nuk ishte në kompetencën e kompanisë.	
9. Mangësitë në faturimin e të hyrave.	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që sistemi i përshtatshëm i regjistrimit është vënë në funksion për të mbështetur mbledhjen dhe menaxhimin e të hyrave. Kjo duhet të reflektojë kompleksitetin e sistemit të të hyrave me të cilën operon Kompania.		Vërehen përmirësime rreth faturimeve të të hyrave. Pra janë në proces të zbatimit.	
10. Mangësi në menaxhimin e pagave.	Kryesuesi i Bordit duhet t'i shqyrtoj shkaqet që kanë ndikuar në dështimin e kontrolleve dhe përsëritjen e gabimeve në menaxhimin e personelit. Të kërkojë nga Kryeshefi Ekzekutiv t'i forcoj kontrollet lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të siguroj trajtim me kohe të të gjitha nevojave dhe sfidave të paraqitura.	Janë marrë masat e nevojshme dhe janë aderuar mangësitë në menaxhimin e personelit		
11. Mangësi në procedimin e pagave dhe shujtave.	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj së janë vendosur kontrolle të brendshme dhe të monitoroj sistemin e raportimit me qëllim të pagesës dhe prezantimit të saktë dhe të plotë për paga dhe mëditje	Janë rritur kontrollet e brendshme rreth monitorimit të saktësisë së sistemit për paga e mëditje, është zbatuar.		

12. Mangësi në faturimin dhe pagesat për mallra dhe shërbime	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj kontrole më të fuqishme mbi inicimin, aprovimin, monitorimin dhe pagesën nga kjo kategori. Me qëllim të monitorimit sa më adekuatë të këtyre shpenzimeve duhet të nxjerrën rregulla shtesë që vendosin kontrole mbi shpenzimin e parasë publike për këtë kategori.			Nuk janë forcuar kontrollet e brendshme për ti shmangur blerjet me procedurat përkatëse.
13. Mangësitë në shërbime të kontraktuara	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur kontrollet adekuate dhe janë respektuar obligimet kontraktuese, për çmimet dhe cilësinë e pranimin të mallrave të kontraktuara.		Janë ndërmarrë veprime por ende nuk janë eliminuar të gjitha dobësitë. Është në proces.	
14. Mangësi në menaxhimin e pasurisë	Kryesuesi i Bordit duhet të zbatoj një plan të detajuar të kontroleve duke siguruar mekanizma shtesë për evidentimin dhe eliminimin e këtyre gabimeve me qëllim të prezantimit të saktë dhe të plot të PFV.	Kompania ka bërë veprime për të siguruar vlerë reale të pasurive.		
15. Mangësitë në menaxhimin e llogarive të arkëtushem	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurohet se është bërë harmonizimi i shënimeve kontabël të arkëtushmeve me qëllim të paraqitjes dhe prezantimit të drejt në përputhje me standardët e raportimit financiar. Gjithashtu, të vlerësoj nxjerrjen e një politike kontabël në bazë të standardeve dhe rregullave në fuqi për lejime dhe borxhet e këqija.	Kompania ka bërë veprime për të siguruar vlerë reale të llogarive të arkëtueshme.		
16. Mangësitë në menaxhimin e detyrimeve	Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë marr masat e nevojshme për njohjen real të detyrimeve sipas standardit të kontabilitet, për njohjen e provizioneve për raste kur kompania obligohet që të transferojë përfitime ekonomike si rrjedhojë e transaksioneve ose ngjarjeve nga e kaluar.	Kompania ka bërë veprime për të siguruar vlerë reale të llogarive të pagueshme.		

## Shtojca III: Letër Konfirmimi

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATUMI: 05.06.2018			
Nr. Protokol. Br. Prot.	Nr. Fjalor. Klasif. (KPI) Klasif. (KPI)	Nr. Protokol. Br. Prot.	Nr. Fjalor. Br. Stranica No. Pages
05	401	902	1

  

KMDK SH.A		Dalise <input type="checkbox"/> Hyrese <input type="checkbox"/>
Nr: 343/2018		
Data: 05.06.18		
Kompani: Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A Kosovo Landfill Management Company J.S.C Kompanija za Upravljanje Deponijama na Kosovu DD		

Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë SH.A  
 Kosovo Landfill Management Company J.S.C  
 Tel: 038 544 551, 544 552  
 Adresa: Rr. Musine Kokollari -1 Dardani  
 Prishtinë, Kosovë

### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të Kompanisë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës sh.a, për vitin 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

**z. Lundrim Camaj,**

Kryesues i Bordit të Drejtorëve,

Data: 05.06. Prishtinë.

